

L I G J
Nr.8487, datë 13.5.1999

PËR KOMPETENCAT PËR CAKTIMIN E PAGAVE TË PUNËS

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Paga përfaqëson të ardhurat në para që punëdhënësi i jep punëmarrësit për punën e kryer në sasi, cilësi dhe kohë. Paga përcaktohet në kontratën e punës, e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Neni 2

Në Republikën e Shqipërisë për caktimin e pagës, sipas përkatësisë, kanë kompetencë:

- Kuvendi;
- Këshilli i Ministrave;
- ministritë dhe institucionet e tjera qendrore dhe organet e pushtetit vendor;
- ndërmarrjet shtetërore;
- personat e tjerë juridikë a fizikë, vendas ose të huaj.

Neni 3

Në nenin 2 të këtij ligji me “ndërmarrje shtetërore” nënkuptohen ndërmarrjet me kapital 100 për qind shtetëror, që funksionojnë në mbështetje të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, ndërmarrjet që funksionojnë në mbështetje të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, si dhe institucionet shtetërore jobuxhetore, bankat, INSIG-u dhe institucione të tjera me kapital tërësisht shtetëror, sipas përcaktimit që do të bëjë Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Këshilli i Ministrave cakton pagën minimale mujore, në shkallë vendi, e cila është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj.

Neni 5

Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave përcakton me ligj të veçantë raportet e pagave të funksionarëve të lartë shtetërorë. Në bazë të këtyre raporteve, Këshilli i Ministrave cakton dhe indeksin pagat sipas mundësive financiare të shtetit.

Neni 6

Këshilli i Ministrave përcakton:

- pagat e titullarëve të organeve të larta shtetërore, të institucioneve të tjera qendrore dhe pagat e personave të tjerë të barazuar me ta;

- numrin e klasave, kufijtë e madhësisë së pagës dhe të shtesave mbi pagë, sipas klasave, për punonjësit e aparateve të organeve të larta shtetërore, të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, të organeve të pushtetit vendor, si dhe të institucioneve buxhetore në varësi të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore;

- kompetencat në fushën e pagave, që kanë organet e larta shtetërore, ministrinë, institucionet e tjera qendrore dhe organet e pushtetit vendor, si dhe kufirin maksimal të pagës së drejtuesve të ndërmarrjeve shtetërore;

- masën e indeksimit të pagave në bazë të ndryshimit të pritshëm të indeksit të çmimeve të konsumit, në fillim të çdo viti, si dhe rregullat për zbatimin e tij.

Neni 7

Ndërmarrjet shtetërore i caktojnë vetë pagat e punës, në varësi të mundësive të tyre financiare, sipas programit të zhvillimit të miratuar nga organet përkatëse.

Neni 8

Për ndërmarrjet shtetërore, veprimtaria e të cilave është me humbje dhe subvencionohen nga shteti, Këshilli i Ministrave cakton rregulla të veçanta për kufizimin e pagave.

Neni 9

Ligji nr.7583, datë 13.7.1992 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” shfuqizohet.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2374, datë 20.5.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**